

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**PML 83/2014**

**31 korrik 2014**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Timo Vuojolahti si kryetar i kolegjit, dhe prej gjyqtarëve të Gjykatës Supreme Emine Mustafa dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Natalie Dawson si procesmbajtëse, në lëndën penale P. nr. 02/2012 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës;

Në lëndën penale kundër të pandehurit,

[REDACTED] i lindur më [REDACTED] prill 1958, [REDACTED] me vendqëndrim të tanishëm në [REDACTED] Zonë Polole, Kosovë, emri i të atit [REDACTED]

Lidhur me veprën penale:

Krim i organizuar, në kundërshtim të nenit 274(1) dhe (2) të Kodit të Përkoħshëm Penal të Kosovës (tash e tutje KPK) në lidhje me veprën penale pastrim i parave, në kundërshtim të nenit 10.2 të rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale.

Duke vendosur lidhur me kërkësën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurorja e Shtetit më 4 prill 2014,

Duke marrë parasysh përgjigjen e avokatit mbrojtës [REDACTED] të paraqitur më 3 qershor 2014 në emër të të pandehurit [REDACTED]

Pas këshillimit dhe votimit, në përputhje me nenin 435 të KPK-së, Gjykata Supreme lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i shtetit kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në lëndën PAKR 4/2013 të datës 25 shtator 2013, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

**I. Historia e procedurës:**

- Më 13 tetor 2010, prokurori lëshoi aktvendim mbi nisjen e hetimit kundër disa të dyshuarve në lëndën PPS 41/2010. Prokurori lëshoi aktvendim për zgjerimin e hetimit përfshirjen e një të dyshuarit tjetër. Më 28 mars 2011, prokurori lëshoi aktvendim për zgjerimin e hetimit përfshirjen e të pandehurit [REDACTED]



*JR and SP*

totorit 2014 dy të dyshuarit, [REDACTED] janë ende në arrati.

- b. Më 16 maj 2011, pas kërkesës së Prokurorit Gjyqtari i procedurës paraprake ka lëshuar urdhrat për arrest dhe për bastisje të dyja më 16 maj 2011. Më 17 maj 2011, i pandehurit [REDACTED] është arrestuar dhe paraburgosur, ku ka qëndruar gjatë gjithë procedurës.
- c. Më 14 tetor 2011, Gjyqtari i procedurës paraprake ka vazhduar hetimet deri më 13 prill 2012.
- d. Më 10 nëntor 2011, Prokurori ka ngritur aktakuzën PPS nr. 41/2010 kundër të pandehurit [REDACTED] i pandehurit [REDACTED] është akuzuar në lidhje me veprat penale në vijim:
1. Kontrabandim i malirave, në kundërshtim të nenit 273(1) të KPK-së;
  2. Shmangje nga tatimi, në kundërshtim të nenit 249(1) dhe (2) të KPK-së;
  3. Shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza, në kundërshtim të nenit 298 të Kodit doganor dhe të akcizave;
  4. Pastrim i parave, në kundërshtim të nenit 10.2 të rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale;
  5. Krim të organizuar, në kundërshtim të nenit 274(1) dhe (2) të KPK-së; dhe
  6. Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim të nenit 328(2) të KPK-së.
- e. Më 20 janar 2012, aktakuza është konfirmuar me anë të aktvendimit KA nr. 201/11, dhe gjyqtari për konfirmim ka shpallur të gjitha provat të pranueshme. Ky aktvendim nuk është ankimuar.
- f. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mes të 15 qershorit dhe 20 shtatorit 2012.
- g. Më 20 shtator 2012, është shpallur aktgjykimi. I pandehurit [REDACTED] është shpallur fajtor për pikat 4, 5 dhe 6 të aktakuzës: Pastrim i parave, Krim të organizuar dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.
- h. I pandehurit [REDACTED] është dënuar me katër (4) vite burgim dhe me gjobë prej 1,000 euro për Pastrim të parave; tetë (8) vite burgim dhe me gjobë prej 1,000 euro për Krim të organizuar, dhe një (1) vit burgim për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Dënim i unik është përcaktuar me nëntë (9) vite burgim dhe me gjobë prej 2,000 euro. Koha e kaluar në paraburgim është llogaritur. Arma në pronësi të kundërligjshme të të pandehurit [REDACTED] dy automjete, dhe para të gatshme në euro dhe dinarë të Serbisë, janë konfiskuar. I pandehurit [REDACTED] është urdhëruar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale.
- i. I pandehurit [REDACTED] është liruar nga pikat tjera të aktakuzës.
- j. Më 3 dhjetor 2012, avokati mbrojtës [REDACTED] ka paraqitur ankesë në emër të pandehurit [REDACTED]. Më 31 dhjetor 2012, Prokurori Special ka paraqitur përgjigje (të paafatshme) në ankesë. Më 24 qershor 2013, Prokurori i Apelit [REDACTED] ka paraqitur mendimin dhe propozimin në përgjigje të ankesës.
- k. Më 22 tetor 2013, Gjykata e Apelit ka lëshuar aktgjykimin duke planifikuar ankesën pjesërisht. Gjykata e Apelit ka gjetur si në vijim:



1. Aktakuza është refuzuar në lidhje me veprën Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.
2. Cilësimi juridik i veprës që i atribuohet të pandehurit [REDACTED] ndryshohet sipas nenit 420(1), (4) dhe 426(1) të Kodit të Përkoħshem tē Procedurës Penale tē Kosovës (tani e tutje KPPK-së):
  - 2.1 Dënim i në lidhje me Pastrimin e parave është anuluar.
  - 2.2 I pandehurit [REDACTED] është dënuar për Krim tē organizuar në kundërshtim tē nenit 274(1) dhe (2) të KPK-së, në lidhje me Pastrimin e parave në kundërshtim tē nenit 10.2 tē Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit tē parave dhe veprave tē ngashme penale.
3. I pandehurit [REDACTED] është dënuar me katër (4) vite burgim dhe me gjobë prej 1,000 euro.
4. Vendimi për konfiskimin e sendeve tē përmendura më lartë është anuluar.
5. Pjesa e mbetur e aktgjykimit tē Gjykatës Themelore në Mitrovicë tē datës 20 shtator 2012, është konfirmuar.
  - i. Më 4 prill 2014, Prokurori i Shtetit ka paraqitur kërkësë për mbrojtje tē ligjshmërisë kundër aktgjykimit tē Gjykatës së Apelit më 22 tetor 2013.
  - m. Më 3 qershor 2014, avokati mbrojtës [REDACTED] ka paraqitur përgjigjen ndaj kërkësës për mbrojtje tē ligjshmërisë në emër tē pandehurit [REDACTED]

## II. Qëndrimet e palëve

### Prokurori

- a. Gjykata e Apelit deri më tani në këtë lëndë ka zbatuar ligjin e pazbatueshëm sepse ka gjetur se bashkimi në mes tē veprave penale Pastrim i parave dhe Krimit tē organizuar kanë qenë i qartë, ideal apo bashkëveprim aktual. Prokurori pohon se bashkimi i veprave është real.
- b. Kjo mbështetet edhe me jurisprudencën e Gjykatës Supreme tē Kosovës. Aktgjykimi tē referuar nga Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj në mbështetje tē gjetjeve tē saj në lidhje me këtë ka devijuar nga precedenti i mëparshëm.
- c. Kufijtë e shqyrtimit tē Gjykatës së Apelit kufizohet në bazat ligjore tē ngritura nga mbrojtja në ankesën e saj. Rrethanat lehtësuese nuk janë ngritur nga mbrojtja, prandaj Gjykata e Apelit nuk ka qenë e lejuar që t'i shqyrtoj ato.
- d. Gjykata e Apelit 'e ka bazuar vendimin e saj në supozimin se aktet e pastrimit tē parave ... mund tē përfshihen në amnistji.' Prokurori i shtetit pohon se baza për amnistji nuk është vërtetuar nga Gjykata e Apelit.
- e. Gjykata e Apelit ka dështuar që tē peshojë faktorët lehtësues në krahasim me faktorët rëndues gjatë përcaktimit tē dënimit tē duhur. Prokurori më tutje pohon se dënim i shqiptuar ndaj tē pandehurit është më i ulët se minimumi i paraparë sipas nenit 274(1) dhe (2) të KPK-së.

### Mbrojtja



- a. Së pari, avokati mbrojtës i referohet rrethanave faktike duke thënë se nuk ka asnjë arsy që lënda të kthehet qoftë në gjykatën e shkallës së parë apo atë të shkallës së dytë.
- b. Së dyti, kërkesa është paraqitur vonë sepse është paraqitur në 'ditën e fundit të afati ligjor'.

### **III. Gjetjet e Gjykatës:**

- a. Gjykata Supreme konsideron se kërkesa përmbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur me kohë dhe është e pranueshme. Palët kanë të drejtë të paraqesin kërkesa të tilla gjatë ditëve të periudhës së përcaktuar me ligj. Fakti se Prokurorja e Shtetit ka paraqitur kërkesën e saj në ditën e fundit të asaj periudhe është i parëndësishëm.

#### **Kufijtë e shqyrtimit të ankesës**

- b. Prokurori pohon se rrethanat lehtësuese nuk janë ngritur në ankesë nga mbrojtja, prandaj Gjykata e Apelit nuk ka qenë e lejuar që t'i shqyrtoj ato. Gjykata Supreme gjen se ky pretendim është pa merita. Avokati mbrojtës në ankesën e tij të paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë pohon se dënim i shqiptuar ndaj të pandehurit ~~██████████~~ ka qenë i gabuar, dhe përmë tepër, i është referuar gjetjes së gabuar të rrethanave rënduese dhe dështimit që t'i kushtohet rëndësi e duhur rrethanave lehtësuese. Duhet vërejtur se gjykata përcakton dënimin (brenda kufijve të përcaktuar me ligj) duke marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat janë të rëndësishme përmë zbutjen apo rëndimin e dënimit, siç është përcaktuar në nenin 64 të KPK-së. Gjykata Supreme gjen se në lidhje me këtë nuk ekziston asnjë shkelje e dispozitave të procedurës penale.

#### **Dënim**

- c. Neni 274 (1) i KPK-së përcakton *kushdo që kryen 'Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me... burgim së paku shtatë vjet'*. Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Qarkut ka zbatuar këtë dispozitë gjatë llogaritjes së dënimit (duke iu referuar nenit 10.3 të aktgjykimit të saj të datës 20 shtator 2012). Prandaj, dënnimi minimal përmë veprën penale Krim i organizuar në këto rrethana është shtatë vite.
- d. Neni 66 i KPK-së përcakton se '*Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit... kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se edhe me dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit*'.
- e. Neni 67(1) i KPK-së përcakton se '*Kur ekzistojnë kushtet përmë zbutjen... neni 66 i këtij Kodi, gjykata e zbut dënnimin brenda këtyre kufijve... veprën penale është paraparë si masë më e ulët e dënimit me burg... kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se edhe me dënim më të butë mund të zbutet deri në një vit burgim*'.



- f. Neni 67(2) i KPK-së përcakton se *Me rastin e vendosjes së shkallës së zbutjes së dënimit sipas paragrat 1 të këtij nenit, gjykata merr posaçërisht parasysh shkallën më të ulët dhe më të lartë të dënimit të paraparë për vepër penale*.
- g. Gjykata Supreme thekson se këto dispozita i jatin gjykatës diskrecion që të shqiptoj dënim nën minimumin e kërkuar të përcaktuar me këto dispozita për vepra të ndryshme penale kur konstaton se ekzistojnë rrethana lehtësuese, mirëpo brenda kufijve të përcaktuar me nenin 67 të KPK-së.
- h. Në paragrafët 56 dhe 57 të aktgjykimit të saj, Gjykata e Apelit ka përmendur arsyet e saj për shkuarjen nën dënimin minimal të përcaktuar me nenin 274(1) të KPK-së në pajtim me nenit 67(2) dhe 66 të KPK-së. Arsyetimi në këta paragraf tregon se kolegji i Gjykatës së Apelit ka pasur të drejtë, dhe ka marrë parasysh me kujdes, të gjitha rrethanat e lëndës. Kjo përfshin të dy vetit lehtësuese dhe rënduese. Kolegji në mënyrë të qartë ka marrë parasysh secilën dispozitë relevante të KPK-së dhe ka arritur në përfundimin e saj në pajtueshmëri me këtë.
- i. Gjykata e Apelit nuk ka shqiptuar dënim nën minimumin prej një viti si është përcaktuar në nenin 67(1) të KPK-së. Prandaj, nuk ka shkelje të ligjit penal në lidhje me kohëzgjatjen minimale të burgimit.
- j. Në të njëjtin paragraf (56) të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit janë bërë të qarta vërejtjet specifike të kolegit në lidhje me dispozitat e Ligjit për amnistinë. Gjykata e Apelit i ka dhënë rëndësi efektit të mundshëm të Ligjit për amnistinë duke theksuar se ‘...veprat e Pastrimit të parave përfshijnë të ardhura nga aktivitetet kriminale të cilat mund të përfshihen në amnistit.’ Gjykata e Apelit ka arsyetuar se ‘...mund të ndodhë që [REDAKTUE] do të dënohet për pastrim të përfitimit nga të ardhurat e lartpërmendura kriminale, por personat të cilët në fakt kanë kryer krimet e referuara më lart do të mund të lironen për shkak të amnistisë.’
- k. Arsyetimi në paragrafin 56 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të kuptohet se Gjykata e Apelit ka marrë parasysh dispozitat e Ligjit për Amnistit sepse ato ndikojnë në pozitën e personave të tjerë të përfshirë në të njëtin grup, më shumë sesa në vetë të pandehurin. Gjykata e Apelit kanë marrë parasysh efektin që këto dispozita kanë për individët e tjerë të grupit si dhe pozitën e vogël të të pandehurit [REDAKTUE] për të siguruar mbizotërimin e proporcionalitetit.
- l. Fakti se një kolegj tjetër mund të mos pajtohet sa i përket relevancës dhe rëndësisë së rrethanave të përshkruara më lart nuk do të thotë se Gjykata e Apelit ka shkelur dispozitat e llogaritjes së dënimit gjatë marrjes parasysh së këtyre argumenteve si rrethana lehtësuese. Duhet vërejtur se nenit 64.1 i KPK-së i jep diskrecion të madh gjykatës që të vendosë se çfarë mund të konsiderohet si rrethana lehtësuese. Kolegji i Gjykatës Supreme ka asnjë shkelje të qartë të ligjit penal.



m. Në përbledhje, lidhur me sasinë e dënimit dhe arsyetimit prapa tij, Gjykata Supremi nuk gjen asnjë shkelje të ligjit penal. Nuk ekziston asnjë arsy që të ndërhyhet në arsyetimin e Gjykatës së Apelit.

Nëse vepra penale e Krimit të organizuar duhet të absorbojë veprën penale të Pastrimit të parave

- n. Kolegji gjen se gjetjet e kolegit të Gjykatës së Apelit në lidhje me këtë janë të qëndrueshme.
- o. Kolegji është i mendimit se qëndrimi i Gjykatës Supreme përkizazi me këtë është se, kur Krimi i organizuar dhe vepra penale bazë të dyja janë përcaktuar në ligj, duhet të ketë vetëm një dënim për Krim të organizuar në lidhje me veprën penale bazë. Në këtë rast i pandehuri [REDACTED] duhet të dënohet për Krim të organizuar në lidhje me Pastrimin e parave, sikurse ka menduar Gjykata e Apelit.
- p. Në mbështetje të kësaj, Gjykata Supreme citon gjetjen në lëndën nr. Ap-Kz 61/2012 në aktgjykimin e datës 2 tetor 2012. Në paragrafin 48, Gjykata Supreme ka theksuar se, 'Formulimi i përdorur në tërë nenin 274 të KPK-së në mënyrë të qartë përcakton se kryerja e veprës penale bazë është element përbërës i veprës penale Krim i organizuar.' Në këtë parim të jurisprudencës është mbështetur Gjykata e Apelit në këtë lëndë dhe Gjykata Supreme nuk sheh asnjë arsy që të mos pajtohet me këtë vlerësim.

Çështja është vendosur me shumicë votash. Mendimi pjesërisht mospajtues i Gjyqtarit Timo Vuojolahti është i bashkangjitur.



**Kryetar i kolegjit:**

---

Timo Vuojolahti  
Gjyqtar i EULEX-it

**Procesmbajtëse:**

---

Natalie Dawson  
Zyrtare ligjore

**Anëtarët e kolegjit:**

---

Emine Mustafa  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Avdi Dinaj  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**PML 83/2014**  
**31 korrik 2014**



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

EAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAÇNOST OTPRAVKA POTVRDJUJË

Punëtori i autorizuar  
Dyalaçeni radnik